



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”

SHPALLJE KËRKESË PËR DONACION

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Në Kabinetin e Hemodinamikës aparatet e pacemaker janë drejt përfundimit; duke qenë se aparati i pacemaker është jetëshpëtues dhe mungesa e tij e bën të pamundur trajtimin e pacientëve që kanë nevojë për të, kjo situatë mund të çojë në rrezikimin e jetës së pacientëve. Ju lutemi për donacion për furnizim me aparate pacemaker në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja normale e punës në kabinet.

Gjate vitin 2023 u vunë mesatarisht 42 pacemaker në muaj, gjatë muajve me aktivitet te plotë e normal të kabinetit të Hemodinamikës në vitin 2024 u vunë mesatarisht 57.4 pacemaker në muaj. Rritja e shkallës së implantimit mund t'i atribuohet faktorëve të tillë si plakja e popullsisë, rritja e prevalencës së sëmundjeve kardiake, diagnostikimi më i mirë dhe më i shpejtë, rritja e ndergjegjësisimit të të sëmurëve, mungesa e ofrimit të trajtimit me pacemaker në shumicën e qendrave të tjera spitalore publike dhe numri shumë i kufizuar i tyre aty ku ofrohet. Nga ana tjetër, porosia për pacemaker per periudhen 10.2023-10.2025 ishte sipas planifikimit të bazuar në konsumin e asaj periudhe i cili siç sqaruam më sipër është më i ulët se konsumi aktual, nevojat janë mbuluar duke u bazuar në planifikim si dhe nje sasi stoku të akumuluar nga periudha e mëparshme, e cila pavarësisht kësaj, nuk ka arritur të mundësojë plotësimin e nevojave për pacemaker për gjatë gjithë periudhës së planifikuar duke qenë se është rritur numri i pacientëve pas planifikimit të bërë. Duke shpresuar në kontributin tuaj në mbulimin e kësaj nevojë, mirëpresim të gjithë të interesuarit.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”